

ANËTARËSIMI NË SHSHP

1. Anëtarë të SHSHP-së mund të jenë personat fizikë, arsimimi i të cilëve i përket shkencave humane (psikoterapeutike, mjekësore, psikologjike, sociale, pedagogjike) si edhe personat juridikë, veprimtaria e të cilëve shtrihet në fushat e lartpërmendura. SHSHP ka tre lloje të anëtarësisë:

A. Anëtarë me të drejta të plota:

A.1 Profesionistë që kanë përfunduar kualifikimin e plotë në një nga shkollat psikoterapeutike dhe që janë mbajtës të certifikatës shqiptare të psikoterapisë (CSHP) apo certifikatës europiane të psikoterapisë (ECP);

A.2 Profesionistë që kanë të paktën një diplomë master në një nga disipinat e mësipërme, por që kanë përfunduar të paktën 50% të kualifikimit në psikoterapi dhe janë në proces edukimi.

B. Anëtarë me të drejta të pjesshme:

B.1 Individë që kanë të paktën një diplomë master në një nga disipinat e mësipërme nga një institucion akademik i akredituar në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe që kanë eksperiencë të pjesshme klinike/psikoterapeutike, por nuk disponojnë CSHP-në ose ECP-në;

B.2 Profesionistë të kualifikuar të shëndetit mendor që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe që kanë eksperiencë klinike dhe psikoterapeutike;

B.3 Studentë të nivelit universitar ose master në një nga disipinat e mësipërme që kanë interes në disipinën e psikoterapisë.

C. Anëtarë organizativë:

C.1 Organizata që punojnë në fushën e psikoterapisë dhe që pranojnë 'Deklaratën e Strasburgut mbi Psikoterapinë' të vitit 1990.

D. Anëtarët e SHSHP-së përkrahin dhe punojnë për çështje të cilat përputhen me qëllimet dhe objektivat e SHSHP-së. Pranimi në Shoqatë bëhet me kërkesën me shkrim të vetë personit. Emri i tij/saj regjistrohet në Librin e Anëtarëve të Shoqatës.

E. Të gjitha aplikimet për anëtarësim shqyrtohen nga Komisioni i Anëtarësisë.

F. Anëtarët e niveleve të ndryshme janë të detyruar të paguajnë nivele të ndryshme kuotash vjetore anëtarësimi, vlerat e të cilave përcaktohen nga Mbledhja e Përgjithshme.

G. E drejta e votës :

a. Anëtarët me të drejta të plota individuale kanë të drejtë të një vote në Mbledhjen e Përgjithshme.

b. Anëtarët organizativë kanë të drejtën e një vote në Mbledhjen e Përgjithshme për çdo 10 anëtarë të tyre por jo më shumë se 3 vota.

- c. Anëtarët me të drejta të pjesshme mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme si vëzhgues.
- d. Anëtarët me të drejta të pjesshme përfitojnë lehtësira për pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara nga SHSHP.

H. Çdo anëtar pajiset me kartë anëtarësie në SHSHP.